



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.21 dhe 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenin 8 i Udhëzimit administrative me numër Nr.01/2023 për hartimin e akteve normative të KPK-së, më.....miraton:

RREGULLORE NR. __/2025

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr.02/2021 PËR
TRANSFERIMIN DHE AVANCIMIN E PROKURORËVE TË SHETIT**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.02/2021 për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit me qëllim të harmonizimit të dispozitave ligjore që kanë ndryshuar lidhur me kriteret, përbërjen dhe procedurën për transferimin dhe avancimin e prokurorit të shtetit.

Neni 2

Neni 7 Plotësohet/ ndryshohet si në vijim:

Titulli: Në vend të fjalës transferim zëvendësohet me fjalën caktim, kurse pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Paragrafi 2: Fjala transferim zëvendësohet me fjalën caktim, kurse në fund të fjalisë shtohet: dhe pas përfundimit të periudhës së trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë.

Neni 3

Neni 9, paragrafi 1, pika 1.3 e Rregullores bazike të transferimi i përhershëm i prokurorëve nga KPK-ja, **i shtohet teksti** “brenda prokurorisë themelore, me përjashtim Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Speciale”.

Neni 4

Neni 11, paragrafi 1, pika 1.5, ndryshohet si në vijim “nga Departamenti për Krime të Rënda dhe Departamenti për të Mitur i Prokurorisë Themelore”, pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Neni 5

Neni 12, paragrafi 1, pika 1.2 të ndryshohet si në vijim: “të ketë vlerësim pozitiv të performancës”.

Neni 12, paragrafi 1, pika 1.3 të fshihet fjala qortimi.

Neni 6

Neni 13, paragrafi 1, pika 1.2 i rregullores bazike të kriteret e veçanta për avancim, **ndryshohet teksti**, i cilit tani e tutje do të jetë, si në vijim:

“për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, prokurori duhet të ketë se paku tri (3) vite përvojë si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo departamentin për të mitur të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe vlerësim pozitiv të performancës”

Neni 13, paragrafi 1 pika 1.4 i rregullores bazike të kriteret e veçanta për avancim, **i shtohet teksti** “ prej tyre së paku tre (3) vite në Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale apo Departamentin për Krime të Rënda ose Departamentin për të Mitur të Prokurorive themelore si dhe vlerësim pozitiv të performancës ”.

Neni 7

Neni 19 i rregullores bazike, te Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve, **ndryshohet teksti**, i cili tani e tutje do të jetë, si në vijim:

1. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, si në vijim:

- 1.1 Kryeprokurori i Shtetit, i cili do të jetë kryesues,
- 1.2 Anëtari i Këshillit nga radhët e Prokurorisë se Apelit,
- 1.3 Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse për të cilën shpallet konkursi.

2. Me rastin e shpalljes së konkursit për ZKPSH-në nga pika 1.3, një prokuror nga ZKPSH i përzgjedhur nga Këshilli.

3. Komisioni do të ketë anëtarët rezervë sipas përbërjes në vijim:

- 3.1 Zëvendëskryeprokurori i Zyrës se Kryeprokurorit të Shtetit;
- 3.2 një anëtar i Këshillit, i zgjedhur me short;
- 3.3 Zëvendëskryeprokurori i prokurorisë përkatëse dhe
- 3.4 Në rast të përjashtimit të anëtarit nga paragrafi 2 i këtij neni, zëvendësohet me një prokuror tjetër nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 8

Neni 22 riformulohet si në vijim: ”KPK-ja vendos për kundërshtimin në takimin e parë të KPK-së, por jo më vonë se 30 ditë pune nga dita e pranimi të kundërshtimit”.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më _____ 2025

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës